

VENDIM
Nr.784, datë 15.9.2006

PËR RISTRUKTURIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE ME KAPITAL SHTETËROR
“ALBPETROL” SHA, “SERVCOM” SHA DHE “TRANSNAFTA” SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 243 e 253 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, të nenit 4 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkimin me shoqërinë “Albpetrol” sh.a. Patos, me anë të përthithjes së shoqërive “Servcom” sh.a. e “Transnafta” sh.p.k.

2. Punonjësit e shoqërive “Servcom” sh.a. e “Transnafta” sh.p.k. që dalin të papunë si pasojë e rristurimit, përfitojnë, për një periudhë njëvjeçare, pagesë me pagë bruto mesatare, mujore, individuale të vitit të fundit të punës. Në përfundim të kësaj periudhe, punonjësit kanë të drejtë të aplikojnë për të ardhurën nga papunësia.

3. Periudha, gjatë së cilës këta persona do të përfitojnë pagesën e përcaktuar në këtë vendim, njihet periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie, invaliditeti dhe familjar, kundrejt pagesës së kontributit në fondin e sigurimit të detyrueshëm shoqëror nga “Albpetrol” sh.a. Periudha e mësipërme e pagesës shënohet në librezën e punës.

4. Fondi i nevojshëm, për kryerjen e pagesave të punonjësve, që dalin të papunë nga rristurimi i këtyre shoqërive, të përballohet nga likuiditetet e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., e cila do të kryejë këto pagesa çdo muaj.

5. Pagesa sipas këtij vendimi ndërpritet, kur përfituesit zhvillojnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit apo të vetëpunësimit.

6. Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. do t’i shtohen nga shoqëritë “Servcom” sh.a. e “Transnafta” sh.p.k. të gjitha asetet, për zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe që gjenerojnë të ardhura, të cilat duhet të paraqiten në bilancin e saj.

7. Sistemimin e detyrimeve të ndërsjella, debitore dhe kreditore, të shoqërive të mësipërme dhe pasqyrimin, në bilancin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., të diferencave të rezultuara.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha